



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 26, datë 07.10.2021

PËR

“RIALOKIM KUOTE TË PRANIMIT NGA TROJET TË CIKLIT TË PARË TË  
STUDIMEVE BACHELOR NË PROGRAMIN E STUDIMIT KOREOGRAFI, NË  
FAKULTETIN E ARTIT SKENIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e paraqitur nga Fakulteti i Artit Skenik me nr. 1246 Prot., datë 04.10.2021 , pasi diskutoi rreth kërkesës së paraqitur nga FAS, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Ti kërkohet MASR miratimi i riallokimit të 1 kuote të pashfrytëzuar nga Trojet, për Shtetasit e Malit të Zi në programin e studimit koreografi, dhe kjo kuotë të rishpërndahet dhe të kalojë në dobi të po këtij programi për Shtetasit nga Kosova, sipas kërkesës së paraqitur nga Fakultetit të Artit Skenik, në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të dërgohet në MASR si dhe të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

1246.8.001  
09/10/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEKANI

Nr. 222 prot.

Tiranë, më 01/10/2021

Lënda: Kërkesë për rialokim kuote në ciklin e parë të studimeve Bachelor

REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof. KASTRIOT ÇAUSHI

Për dijëni: Departamentit Skenografi Kostumografi dhe Koreografi në FAS

Zoti Rektor!

Në vijimësi të komunikimeve tona, dëshiroj që nëpërmjet kësaj shkrese të kërkoj nga ana Juaj, rialokim të kuotave nga **TROJET në Ciklin e Parë të studimeve Bachelor** në programin e studimit **koreografi** në Fakultetin e Artit Skenik.

Me Vendimin e Senatit Akademik të UART nr.08 datë 27.04.2021 "*Mbi deklarin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor dhe ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve / Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Arteve*", në programin e studimit Koreografi, cikli i parë i studimeve bachelor, janë miratuar gjithsej 6 (gjashtë) kuota nga trojet. Përkatësisht nga 1 (një) kuotë nga: Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, Medvegja.

Në konkursin e pranimit për Koreografi në Fakultetin e Artit Skenik nga trojet u paraqitën vetëm 2 (dy) kandidatë nga KOSOVA. Fakulteti është i detyruar të shpallë vetëm 1 (një) fitues, nisur nga kuotat e miratuara në Senatin Akademik.

Nisur nga sa më sipër si dhe nga fakti se në programin e studimit koreografi vlerësimi me pikë i një kandidati poshtë vijës së kuqe, pjesëmarrës në konkurs, është në nivelin e 115,96 pikëve,

Departamenti Skenografi Kostumografi dhe Koreografi ka paraqitur një kërkesë për rialokim kuote dhe konkretisht kërkojnë:

- **1 (një) kuotë e pashfrytëzuar nga Trojet për programin e studimit koreografi të rishpërndahet dhe të kalojë në dobi të këtij programi.**

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTIT SKENIK  
DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI DHE KOREOGRAFI

TIRANË 30/09/2021

**LËNDA:** Kërkesë për rialokim kuote për kandidatë nga TROJET në programin e studimit Koreografi, në ciklin e parë të studimeve Bachelor.

**Drejtuar:** **DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK**  
**Prof. Petrit MALAJ**

Zoti Dekan!

Këto ditë ne si departament zhvilluam konkursin e pranimit për studentët e ciklit e parë të studimeve bachelor.

Ne Departamentin Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi, në programin e studimit Koreografi nga TROJET u shpall 1 (një) fitues nga Kosova.

Duke qenë se nga Kosova konkuruan 2 (dy) kandidatë në programin e studimit Koreografi, dhe nga rezultatet e konkursit të pranimeve edhe kandidati i ngelur jashtë, ka pikët e mundshme për tu shpallur fitues, ne propozojmë që të rialokohet një kuotë duke shfrytëzuar për këtë qëllim 1 (një) kuotë të pashfrytëzuar nga kuotat nga trojet.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**Prof.asoc. Taulant PUSTINA**

**Përgjegjës i departamentit**

